



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ .2018

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit

Për: K.M.K + SARDO. Adresa: Fier, Ballsh, Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr. Pasurie 7/9810/Ndertese.

Procedura e prokurimit: Proçedurë E hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-85768-09-14-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “Rikonstruksion rruga Shqipja Arbnore”, me fond limit: 13’332’000 lekë, sasia sipas preventivit afati 90 ditë.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike. [Nr.38 datë 24 Shtator 2018]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|--------------------------|
| 1. K.M.K
+SARDO | L78223801E
K13120402W |
| Vlera 7’273’757 (shtatë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë. | |
| 2. 2AF ALBANIA GROUP
+ALB LEAA INTERNATIONAL | L32005501M
J86906408N |
| Vlera 7’913’284 (shtatë milion e nentëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë. | |
| 3. SHKELQIMI 07 | K68121808W |
| Vlera 8’000’000 (tetë milion) lekë | |
| 4. INA | J61814009W |
| Vlera 8’099’281 (tetë milion e nentëdhjetë e nentë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekë. | |
| 5. NIKA | J76705047U |
| Vlera 8’399’872 (tetë milion e treqind e nentëdhjetë e nentë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë | |
| 6. LIQENI VII | K01730502W |
| Vlera 8’549’113 (tetë milion e pesëqind e dyzet e nentë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë. | |
| 7. GURI NDERTIM
+ ED KONSTRUKSION | J91425005N
K61625001I |
| Vlera 8’650’970 (tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë) lekë. | |
| 8. K-AAV | L51506025C |
| Vlera 8’729’868 (tetë milion e shtatëqind e njëzet e nentë mijë tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë | |

- | | |
|--|------------|
| 9. ALB SHPRESA | J72110003F |
| Vlera 8'999'999 (tetë milion e nentëqind e nentëdhjetë e nentë mijë e nentëqind e nentëdhjetë e nentë). | |
| 10. BEQIRI | J98624801V |
| Vlera 9'006'836 (nëntë milion e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë. | |
| 11. S P E K T R I | J62903555F |
| Vlera 9'110'319 (nëntë milion njëqind e dhjetë mijë e treqind e e nentëmbëdhjetë) lekë. | |
| 12. BONUS sh.p.k | K72412009E |
| Vlera 9'216'337 (nëntë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë. | |
| 13. GLAVENICA | K17710805A |
| Vlera 9'528'455 (nëntë milion e pesëqind e njetetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë. | |
| 14. NEAL-86 | K04814851T |
| Vlera 9'737'708 (nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetë) lekë. | |
| 15. EURONDERTIMI 2000 | K02003001O |
| Vlera 9'796'797 (nëntë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nentëdhjetë e shtatë) lekë. | |
| 16. COMPANY RIVIERA 2008 | K81716011V |
| Vlera 9'936'130 (nëntë milion e nentëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë. | |
| 17. KUPA | K51615512C |
| Vlera 10'001'877 (dhjetë milion e njëmijë e teteqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë. | |
| 18. Shendelli | K07924803N |
| Vlera 10'013'433 (dhjetë milion e trembedhjetë mijë e katerqind e tridhjetë e tre) lekë. | |
| 19. DAJTI PARK 2007 | K11507003S |
| Vlera 10'052'512 (dhjetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë. | |
| 20. SARK | K52531415H |
| Vlera 10'502'519 (dhjetë milion e pesëqind e dy mijë e pesëqind e nentëmbëdhjetë) lekë | |
| 21. BIBA-X | K32618815N |
| Vlera 13'197'184 (trembedhjetë milion e njëqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë. | |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. K-AAV
2. ALB SHPRESA
3. BEQIRI
4. S P E K T R I
5. NEAL-86
6. EURONDERTIMI 2000
7. SARK
8. BIBA-X

Per arsyet e meposhtme:

- Ofertuesi K-AAV me vlere te ofertes 8'729'868 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

- Per: "KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT", pika 2.3 Për kapacitetin teknik, germa .f

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6'000'000 lekë, të realizuar gjatë tri viteve të fundit; ose Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 24'000'000 lekë; Si deshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontraten/kontratat me Autoritetet Kontraktore publike apo private të shoqëruara me faturën/faturat tatimore, formular vlerësimi sipas shtojcës e shoqëruar me akt kolaudimin dhe situacionet.

- Ofertuesi K-AAV ka paraqitur nje Kontrate Siper marrje e lidhur midis tij dhe vetes se tij(shoqerise K-

AAV)per objektin: “Ndertim i Kantierit te Shoqerise K-AAV”, bashkangjitur ka paraqitur nje Fature Tatimore Shitje, ku shites dhe bleses eshte shoqeria K-AAV sh.p.k, gjithashtu ofertuesi K-AAV bashkangjitur kesaj kontrate ka paraqitur dhe Formular Vleresimi sipas shtojces 8, ku Autoriteti kontraktor/Investitori eshte Shoqeria K-AAV dhe operatori ekonomik eshte po Shoqeria K-AAV, si perfundim operatori K-AAV ka vlersuar veten, kjo perben konflikt interesi pasi per vleresimin e nje pune duhet te vleresohet nga nje autoritet tjetër dhe jo nga ai vete qe ka kryer punet.

- Per: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa g.

NP-1 A Punime germimi ne toke.

NP-4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP-7 A Ujesjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve,

NP-12 A Punime te inxhinjerise se mjedisit.

NS-18 A Punime topogjeodezike

- Ofertuesit K-AAV, ne Liçensa profesionale te tij, mungon pika e licences *NP-12 A. “Punime te inxhinjerise se mjedisit”.*

- Per: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, pika 2.3 Për kapacitetin teknik, **germa. h**

Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje (per stafin te paraqitet dokumentacion qe verteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, license e mjekut, deshmi profesionale te punonjesve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj):

- *Inxhinier Ndertimi* 1 (nje)
- *Inxhinjer Hidroteknik* 1 (nje)
- *Inxhinjer Topograf* 1 (nje)
- *Inxhinjer Mjedisit* 1 (nje)
- *Teknik ndertimi* 1 (nje)
- *Mjek* 1 (nje)
- *Punetori e specializuar me makineri, manovratore* 3 punonjes
- *Punetori e specializuar ne ndertim* *Karpentier* 3 punonjes

- Ofertuesi K-AAV ne lidhje me stafin e sipercituar rezulton si me poshte;

Ofertuesi K-AAV, Inxhinjerin e Ndertimit z.Fatmir Muka nuk e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 13/03/2015 me afat 5(pese) vjecar, ofertuesi K-AAV nuk i ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore Inxhinjerit te Ndertimit z.Fatmir Muka.

Ofertuesi K-AAV, Inxhinjerin Hidroteknik z.Gani Sina, e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet vetem tre muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku per keto tre muaj, ofertuesi K-AAV ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vetem nje dite ne muaj, edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 01/09/2017 me afat 10(dhjete) vjecar, ofertuesi K-AAV nuk ka respektuar kushtet e kontrates, ku per te cilin duhej te shlyente detyrimet qe nga periudha kur eshte lidhur kjo kontrate.

Ofertuesi K-AAV, Inxhinjerin Topograf(*Gjeodet*) z.Pavullo Shkarpa, e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet vetem tre muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku per keto tre muaj, ofertuesi K-AAV ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vetem nje dite ne muaj edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 01/09/2017 me afat 10(dhjete) vjecar, ofertuesi K-AAV nuk ka respektuar kushtet e kontrates, ku per te cilin duhej te shlyente detyrimet qe nga periudha kur eshte lidhur kjo kontrate.

Ofertuesi K-AAV, Inxhinjeren e Mjedisit zj.Luljeta Demushi nuk e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 03/10/2017 me afat 10(dhjete) vjecar, ofertuesi K-AAV nuk ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore Inxhinjeres se Mjedisit zj.Luljeta Demushi.

Ofertuesi K-AAV, Mjekun z.Besnik Xhindole, e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet vetem tre muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku per keto tre muaj, ofertuesi K-AAV ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vetem nje dite ne muaj edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 01/10/2017 me afat 10(dhjete) vjecar, ofertuesi K-AAV nuk i ka respektuar kushtet e kontrates, per te cilin duhej te shlyente detyrimet qe nga periudha kur eshte lidhur kjo kontrate.

Persa i perket punonjesve te tjere si: Teknik ndertimi, manovratore, karpentiere dhe punetoreve te ndertimit te tjeshte, ofertuesi K-AAV i ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet vetem tre muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku per keto tre muaj, sipas listepagesave, rezuloton se ofertruesi K-AAV ka derdhur kontribute, vetem nje dite pune ne muaj.

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, ne germen k te tij, per listepagesat, kerkuar si me poshte;

List pagesat sipas formulareve standarte për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 24 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”) Dokumenta te konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ne fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

- Ofertuesi K-AAV i ka paraqitur listepagesat e sipercituar, duke iu referuar numrit mesatar te punonjesve per gjashte muajt e fundit qe i takojne me daten e hapjes se ofertave, ky numer afersisht eshte 12 punonjes dhe jo 24 punonjes ashtu siç eshte keruar ne DT.

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, eshte kerkuar qe:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Shtojcat që janë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik

- Ofertuesi K-AAV nuk ka paraqitur Shtojcen 11 “DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES”.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi ALB SHPRESA me vlere te ofertes 8’999’999 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e konkretisht:

- Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, ne piken 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Nder te tjera;

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Ofertuesi ALB SHPRESA nuk e ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi BEQIRI me vlere te ofertes 9’006’836 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e konkretisht:

- Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, ne piken 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Nder te tjera;

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Ne lidhje me vërtetimin e sipercituar që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, ofertuesi BEQIRI ka paraqitur nje vertetim qe mban daten 18.07.2018, e cila perfshin detyrimet deri ne muajin Qershor 2018 duke perfshire dhe kete te fundit, ofertuesi BEQIRI kishte te gjithë kohen e mjaftueshme per ti shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike (te muajve Korrik dhe Gusht 2018) qe i takojne deri me daten e hapjes se tenderit.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi S P E K T R I me vlere te ofertes 9’110’319 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, eshte kerkuar qe:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Shtojcat që janë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik

- Ofertuesi S P E K T R I nuk ka paraqitur Shtojcen 11 “DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES”.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi NEAL-86 me vlere te ofertes 9’737’708 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, ne piken 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa f;

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6’000’000 lekë, të realizuar gjatë tri viteve të fundit; ose Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 24’000’000 lekë; Si deshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontraten/kontratat me Autoritetet Kontraktore publike apo private të shoqëruara me faturën/faturat tatimore, formular vlerësimi sipas shtojcës e shoqëruar me akt kolaudimin dhe situacionet.

- Ofertuesi NEAL-86, per pune te ngjashme, ka paraqitur nje kontrate me Bashkine Vlore, i cili ne kete kontrate ka marre persiper 60% te punimeve te kesaj kontrate dhe shoqeria KLAIGER shpk ka marre persiper 40% te punimeve te kesaj kontrate, vlera e kontrates se realizuar nga ofertuesi NEAL-86, per pjesen e vet, eshte më të vogël se 6’000’000 lekë.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi EURONDERTIMI 2000 me vlere te ofertes 9’796’797 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, eshte kerkuar qe:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Shtojcat që janë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik

- Ofertuesi EURONDERTIMI 2000 nuk ka paraqitur Shtojcen 11 “DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES”.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi SARK me vlere te ofertes 10’502’519 lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, ne piken 2.3 “Për kapacitetin teknik”, **germa f;**

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6’000’000 lekë, të realizuar gjatë tri viteve të fundit; ose Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 24’000’000 lekë; Si deshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontraten/kontratat me Autoritetet Kontraktore publike apo private të shoqëruara me faturën/faturat tatimore, formular vlerësimi sipas shtojcës e shoqëruar me akt kolaudimin dhe situacionet.

- Ofertuesi SARK ka paraqitur kontrata per pune te ngjashme e konkretisht; me Bashkine Durres 2(dy) kontrata, me Bashkine Korce 1(nje) kontrate, me Keshillin e Qarkut Berat 1(nje) kontrate dhe me Ndermarrjen e Rugeve Rurale Gjirokaster 1(nje) kontrate, ku asnjera nga kontratat nuk e permbush kriterin **per vleren**, per Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6’000’000 lekë, dhe te gjitha se bashku nuk e permbushin kriterin **per vleren**, per Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 24’000’000 lekë.

- Ofertuesi SARK ne Licencen e tij te Shoqerise, regjistruar ne regjistrin themeltar qe nga data: 13.03.2017, drejtuesi teknik, Inxhinjeri Gjeolog Taip Doga, mungon ne listepagesat per sigurimet, për periudhen që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 21/06/2018 (**kontrate pa afat**), ofertuesi SARK nuk i ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore Inxhinjerit Gjeolog Taip Doga.

- Per: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, pika 2.3 Për kapacitetin teknik, **germa. h**

Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje (per stafin te paraqitet dokumentacion qe verteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, license e mjekut, deshmi profesionale te punonjesve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj):

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinjer Topograf 1 (nje)
- Inxhinjer Mjedisi 1 (nje)
- Punetori e specializuar me makineri, manovratore 3 punonjes
- Punetori e specializuar ne ndertim

- Ofertuesi SARK ne lidhje me stafin e sipercituar rezulton si me poshte;

Ofertuesi SARK, Inxhinjerin e Ndertimit z.Astrit Sila nuk e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet, për periudhen që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 10/05/2018 (**kontrate pa afat**), ofertuesi SARK nuk i ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore Inxhinjerit te Ndertimit z. Astrit Sila.

Ofertuesi SARK, Inxhinjerit Topograf(*Gjeodet*) z.Vasil Peci, i ka shlyer detyrimet per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vetem nje dite ne muaj, ne kontratn individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 12/12/2016 me afat 5(pese) vjecar, ofertuesi SARK nuk ka respektuar kushtet e kontrates, ku per te cilin duhej te shlyente detyrimet qe nga periudha kur eshte lidhur kjo kontrate, me kohe te plote.

Ofertuesi SARK, Inxhinjeren e Mjedisit zj.Ermelinda Agalliu, i ka shlyer detyrimet per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore vetem nje dite ne muaj, ne kontratn individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 20/02/2015 me afat 5(pese) vjecar, ofertuesi SARK nuk ka respektuar kushtet e kontrates, ku per te cilen duhej te shlyente detyrimet qe nga periudha kur eshte lidhur kjo kontrate, me kohe te plote.

Ofertuesi SARK, Manovratorin z.Piro Gjoncaj, nuk e ka te perfshire ne List pagesat për sigurimet, për periudhen që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, edhe pse ne kontraten individuale te punes te lidhur midis tyre qe me date 10/10/2016 me afat 3(tre) vjecar, ofertuesi SARK nuk i ka shlyer detyrimin per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore Manovratorit z.Piro Gjoncaj.

Persa i perket 3(tre) punonjesve karpentiere, ofertuesi SARK ka deklaruar me ane te kotratave individuale te tyre te punes, 3(tre) punonjes e perkatesisht Gjovalin Mali, Pellumb Koci dhe Ridjana Hita, per te cilet nuk verteton se jane me profesin karpentiere, pasi nuk jane te paisur me deshmi profesionale apo te jene te regjistruar ne listepagesa si te tille, kjo referuar dhe listepagesave te ofertuesit SARK, ku kodi i profesionit te ketyre punonjesve ne keto listepagesa eshte per punetore krahu ndertimi dhe jo karpentiere.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

- Ofertuesi BIBA-X me vlere te ofertes 13'197'184 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e konkretisht:

- Per kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa g;

Liçensa profesionale e shoqerisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- Ne Licencen profesionale te Shoqerise BIBA-X, regjistruar ne regjistrin themeltar qe nga data: 15.04.2013, drejtuesit teknik, Jakup Vogli, dhe Elidjon Kaso jane te pasiguruar pasi mungojne ne listepagesat per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Ne: “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, eshte kerkuar qe:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Shtojcat që janë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik

- Ofertuesi BIBA-X nuk ka paraqitur Shtojcen 11 “DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES”.

KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se: K.M.K + SARDO. Adresa: Fier, Ballsh, Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr. Pasurie 7/9810/Ndertese, se oferta e paraqitur me një vlerë të pergjithshme prej 7'273'757 (shtatë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, është identifikuar si oferta e

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.11.2018

Ankesa: ka ose jo __ Jo __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Vangjush Dako

